

URDHËR
Nr. 1007, datë 24.6.2014

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË ZYRTARËVE TË ADMINISTRATËS DOGANORE, TË CILËT U NËNSHTROHEN KUFIZIMEVE TË NENIT 32 TË LIGJIT NR. 9367, DATË 7.4.2005, “PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 42, pika 2, dhe nenit 32 germa “c”, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, bazuar në vendimin nr. 1049, datë 4.12.2013 të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999, “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor, të ndryshuar” dhe rregulloren e brendshme të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

URDHËROJ:

Kategoria e zyrtarëve të administratës doganore që do të përfshihen në kufizimet e parashikuara në nenin 32 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, të cilët nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital në shoqëritë tregtare, që kryejnë veprimtari import-eksporti, kategorizuar sipas funksionit do të jenë:

1. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm
 - Drejtor i Përgjithshëm
 - Zv/Drejtor i Përgjithshëm
 - Këshilltar
2. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm
 - Drejtor drejtorie
3. Drejtoria e Investigimit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit
 - Drejtor drejtorie
4. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës
 - Drejtor drejtorie
5. Drejtoria e Procedurave të Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore
 - Drejtor drejtorie
 - Përgjegjës sektori
6. Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës
 - Drejtor drejtorie
 - Përgjegjës sektori
7. Drejtoria Juridike
 - Drejtor drejtorie
8. Drejtoria e Laboratorit Doganor
 - Drejtor drejtorie
9. Drejtoria e Vlerës Doganore
 - Drejtor drejtorie
 - Përgjegjës sektori
10. Drejtoria Teknike e Akcizës
 - Drejtor drejtorie
11. Drejtoria e Metodikave dhe Kontrollit

- Drejtor drejtorie

12. Drejtoria e Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit

- Drejtor drejtorie
- Përgjegjës sektori
- Komandant grupi
- Inspektor

13. Drejtoria Antitrafik

- Drejtor drejtorie

14. Drejtoria e Hetimit

- Drejtor drejtorie
- Specialist hetues
- Oficer i policisë gjyqësore

15. Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale

- Drejtor drejtorie

16. Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit

- Drejtor drejtorie
- Përgjegjës sektori
- Specialist

17. Drejtoria e Informacionit

- Drejtor drejtorie
- Përgjegjës sektori
- Specialist informacioni

18. Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit

- Drejtor drejtorie

19. Drejtoria e Burimeve Njerëzore

- Drejtor drejtorie

20. Drejtoria e Burimeve Mbështetëse

- Drejtor drejtorie

21. Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit

- Drejtor drejtorie

22. Degët doganore

- Kryetar
- Përgjegjës sektori
- Përgjegjës zyre/turni
- Doganier

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT

Shkëlqim Ganaj